

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike të paditëses SH.A “M.B” Republika e Maqedonisë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Z.K avokat nga P., kundër të paditurës Ndërmarrja Tregtare me shumicë dhe pakicë “B-K” me seli në F, Rruga “A.K” Nr. , të cilën e përfaqëson sipas autorizimit përfaqësuesi ligjor M.B, me objekt kontesti për pagesën e borxhit në shumën prej 24,500.00 euro, në seancën e mbajtur më datë 28.09.2016, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe të autorizuarit të të paditurës, ndërsa me datë 11.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses SH.A “M.B”- Republika e Maqedonisë.

I.DETYROHET e paditura Ndërmarrja Tregtare me shumicë dhe pakicë “B-K” me seli në F, që paditëses SH.A “M.B” t’ia paguajë borxhin kryesor në shumë prej 24,500.00 euro (njëzetë e katërmijë e pesëqind euro), me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 (një) vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga paraqitja e padisë e deri në pagesën definitive në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcimin e përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 748.80 euro, në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja SH.A “M.B”- Republika e Maqedonisë me datën 03.10.2006, ka ushtruar padi pranë kësaj Gjykate me objekt kontesti për pagimin e borxhit në shumën prej 24,500.00 euro.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka mbajtur seancat në të cilën i autorizuar i paditësit i ka propozuar gjykatës që të miratoj kërkesëpadinë e në tërësi si të bazuar me kamatë ligjore që e paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara mbi një vit, duke shtuar se provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës e vërteton bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i të paditurit në përgjigjen në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë si për nga baza juridike ashtu edhe për nga lartësia e saj, po ashtu ka theksuar se padia e paditësit është e vjetërsuar, duke shtuar se nuk e ushtron veprimtarinë e këtij biznesi, po ashtu i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata me qëllim të shqyrtimit të drejtë të kësaj çështjeje i ka administruar provat e prezantuara si në vijim: fatura nr. 1110 e datës 29.10.2003, fletë dërgesa me nr. 108 e datës

29.10.2003, dokumentacioni doganor DUD, R-3570, e datës 29.10.2003, CMR me nr. 002247, EUR pika 1 A 0107384, e datës 29.10.2003, fatura me nr. 1139 e datës 19.11.2003, fletë dërgesa me nr. 137 e datës 19.11.2003, DUD 5824 e datës 19.11.2003, CMR 002452 EUR pika 1 A 0107398 e datës 19.11.2003, Çertifikata e biznesit e të paditurës me nr..., faturat e paguara nga e paditura me nr. 1096 të datës 20.10.2003, fletë dërgesa me nr. 94 e datës 20.03.2003, DUD R-5164 e datës 20.03.2003, CMR 010116, Çertifikata e qarkullimit, raporti i pagesës nga jashtë R.B e datës 15.12.2003, të gjitha janë të përkthyer në gjuhën shqipe nga gjuha maqedonase.

Deklarimet e paditëses, të autorizuarit të paditëses dhe deklarimet e të paditurës, provat e prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha, një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së dhe gjeti, se nuk ishte kontestuese se palët në procedurë kishin pasur marrëdhënie afariste dhe se kjo vërtetohet edhe nga faturat e pranuar nga të dy palët, por kontestuese ishte se e paditura pretendon se malli ka qenë me të meta dhe se kërkesë padia e paditësit është e vjetërsuar.

Nga faturat/ dudat e administruara u vërtetua se të njëjtat ishin pranuar nga e paditura dhe se shuma e faturave të pranuar e të papaguara arrijnë shumën prej 24,500.00 euro. Nga provat e administruara si më sipër rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie afariste për furnizim me shporet me lëndë djegëse të fort dhe paditësja sipas porosive të të paditurës i ka dërguar mallërat dhe faturat përkatëse ndërsa e paditura brenda afatit ligjor asnjëherë nuk i ka kontestuar me shkrim faturat e pranuar, andaj në kuptim të nenit 26 të LMD-së si dhe nenit 42 par 3, i LMD-së, është krijuar raporti detyrimor.

Nga prova e administruara po ashtu vërtetohet fakti se paditësi i ka dërguar mallërat e cekura dhe se e paditura i ka pranuar ato madje këtë fakt nuk e ka mohuar as e paditura, përkundër faktit të pranimit të mallrave e paditura nuk i ka paguar ato, andaj borxhi i saj si detyrim ndaj të paditurës kishte arritur shumën prej 24,500.00 euro.

Po ashtu gjykata vlerësoi edhe pretendimet lidhur me mos veprimtarin e biznesit të tij mirëpo gjykata e hudhi si të pabazuar sepse sipas nenin 48 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare e cila parashihet se personi i cili është pronar i një ndërmarrje individuale, qoftë të regjistruar apo të pa regjistruar, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara ose të imponuara nga një ligj ose kontratë në një ndërmarrje individuale. Kjo përgjegjësi është e pakufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose tërthortë të këtij personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona/asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake, por i padituri gjykatës nuk i ka ofruar asnjë provë të vetme për ta vërtetuar këtë pretendim, ndërsa sipas nenit 319.1 dhe 322.2 palët ndërgjyqëse kanë për detyrë që t'i provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj.

Ndërsa pretendimi tjetër i të paditurës se kërkesëpadia e paditësit është vjetërsuar gjykata një pretendim të tillë e refuzoi si të pa bazuar për shkak se nga data e faturës së fundit 19.11.2003, e deri të paraqitja e padisë me datën: 03.10.2006 nuk ka kaluar afati prej tri vite ashtu si që është paraparë me nenin 374 të LMD-së, andaj dhe nuk ka parashkrim dhe si i tillë pretendimi i palës së paditur është refuzuar si i pabazuar.

Gjykata duke iu referuar nenit 15 dhe 17 të LMD-së, të cilët parashohin se palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të obliguara ti kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit

nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke, andaj në bazë të këtyre dispozitave gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit.

Sipas nenit 262 të LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos-përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë: për taksën për padi dhe aktgjykim shumën prej 200.00 euro, në emër të pjesëmarrjes në dy seanca gjyqësore nga 274.400 euro, gjithsej 548.80 euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 748.80 euro, ndërsa për seancën e datës 07.06.2016 gjykata nuk e mori parasysh pasi që në këtë seancë nuk ka përfaqësuar avokati po përfaqësuesi ligjor i paditësit.

Prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 26,42 paragrafi 3 si dhe 262 të LMD-së, si dhe bazuar në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.EK.nr. 257/15 me datë 11.10.2016

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të njëjtit duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.